



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E SHËNDETËSISË / MINISTRY OF HEALTH
INSPEKTORATI FARMACEUTIK / PHARMACEUTICAL INSPECTORATE

Mjësia Org: -10-
Org. Antikoro: -5-
Org. Dall: -5-
Nr. i Angjeve: -5-
Nr. i Shënimeve: -5-
Nr. i...: -5-

Mr. Tash: 05-1013
Mr. Tash: 05-1013
Data: 16.06.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva- Ministry of Health

Inspektorati Farmaceutik/Farmaceutski Inspektorat/Pharmaceutcial Inspectorate

Raport		
Data/Date/Datum:	16.06.2026	Ref. No. 10/LM-005-26
Për/To/ Za:	Mr.Ph. Mimoza Nuhju, themeluese e barnatores "O2 Pharmacy", Rruga "Ferid Curri p.n. Arbëri", Prishtinë	
Përmes/Through/Preko:	Mr. Sc Remzie Thaçi, Drejtor i Departamentit të IF-së	
Nga/From/Od:	Luljeta Mustafa, Inspektor farmaceutik Altina Hoxha, Inspektor farmaceutik	
Lënda/ Subject/Tema:	Raport i inspektimit për Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale "O2 Pharmacy", Prishtinë	
Cc:	Dr Arben Vitia, Ministër në Detyrë i Shëndetësisë Z Jahë Gecaj, Ushtrues i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në MSH Mr.Ph. Labinot Zeqiri, Kryeinspektor Qëndror i Shëndetësisë Mr.Ph. Arian Ahmeti, Zëvendësues i Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në AKPPM	

I. Përmbledhja

Me datë 19.05.2026 Inspektorati Farmaceutik ka kryer inspektim me parashitje, në barnatoren "O2 Pharmacy" me adresë: rruga "Ferid Curri p.n. Arbëri" në Prishtinë. Inspektimi i bazuar në Ligjin për Shëndetësi 04/L-125, Ligjin për Inspektim 08/L-067, Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale 04/L-190, Udhëzimin Administrativ për Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale 11/2015 dhe Ligjin 05/L-087 për Kundërvajtje të Republikës së Kosovës.

Prezent gjatë inspektimit ishte Mr.Ph. Mimoza Nuhju- pronare dhe farmacistë përgjegjëse e barnatores.

Në fund të inspektimit u përpilua procesverbali me numër 0110349 i cili i është lexuar palës dhe është nënshkruar nga pala prezente pa ndonjë vërejtje apo pretendim.



II. Metodologjia

Metodat e shfrytëzuara gjatë inspektimit:

- **Intervistimi:** Bashkëbisedimi me farmacisten përgjegjëse/pronare e barnatores, Mr.Ph. Mimoza Nuhui
- **Mbledhja e fakteve:** Licenca e barnatores, Çertifikata e biznesit, Licenca e farmacistit përgjegjës
- **Observimi:** Gjatë inspektimit janë kontrolluar produktet dhe pajisjet medicinale

III. Faktet

Bazuar në parashtresë/ ankesën e arritur në Inspektoratin Farmaceutik, më datë 19.05.2026 është kryer inspektim në barnatoren "O2 Pharmacy" në Prishtinë, lidhur me dyshimin për operim me produkte medicinale të paaautorizuara (ilegale).

Gjatë kontrollës së produkteve dhe paisjeve medicinale në hapësirën e produkteve termolabile (frigorifer) janë gjetur produkte pa banderolë, për të cilat pala nuk ofroi dëshmi për prejardhjen e tyre, të njejtat janë regjistruar në proceverbal dhe janë konfiskuar nga IF.

Me rastin e inspektimit janë marrë:

Amp Pregnyl 5000IU, nr. serik N132426, dt.sc. 11/2029 (4 copë);

Novo Rapid , nr.serik PRTV94, dt.sc 05/2025 (1copë);

Lantus, nr.serik 45F02354, dt.sc. 02/2026 (4 copë);

Levimir Flex Pen, nr.serik PRTOND3, dt.sc. 06/2024 (3 copë).

Inspektimi është kryer në prezencë të farmacistes përgjegjëse.

Përmes procesverbalit me numër 0110349 është urdhëruar pala që në barnatore të punojë vetëm me produkte dhe pajisje medicinale në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

IV. Konstatimet

- Barnatorja "O2 Pharmacy" me seli në Prishtinë, posedon licencë valide të punesa të lëshuar nga AKPPM, me numër L5-0374/15/07/2022 me pronare/farmaciste përgjegjës Mr.Ph. Mimoza Nuhui.
- Gjatë inspektimit në hapësirat e barnatores u gjetën produkte medicinale të paaautorizuara për qarkullim në tregun e Republikës së Kosovës, të cilat ishin pa banderolë, të njejtat në mbështetje të nenit 16 (paragrafi 5) të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 11/2015 për Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale, që përcakton: "Produktet dhe pajisjet medicinale të cilat nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës apo hasen në subjektet e pa licencuara do të konfiskohen.", u konfiskuan nga Inspektorati Farmaceutik, me ç' rast konstatohet se pala ka vepruar në kundërshtim me nenit 14 (paragrafin 6) të Ligjit 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, që përcakton: "Barnatorja do të blejë produktet medicinale dhe pajisjet medicinale vetëm nga entitetet që janë bartës të Licencës farmaceutike për qarkullim me shumicë.", nenit 12 (paragrafët 1 dhe 2) të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 11/2015 për Qarkulluesit Farmaceutik

me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale që përcakton: “Barnatorja mund të qarkulloj vetëm me barnat sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës.” dhe “Barnatorja mund të furnizohet me produkte medicinale vetëm nga laboratorët galenike të licencuara dhe qarkulluesit me shumicë të licencuar pranë AKPPM-së.”

V. Rekomandimet

- Urdhërohet që në barnatore të punohet vetëm me produkte dhe pajisje medicinale të autorizuara për qarkullim në tregun e Republikës së Kosovës.
- Raportin e shoqëron Vendimi me gjobë numër 10/LM -003-26.
- Për plotësimin e rekomandimeve pala të njoftojë me shkrim Inspektoratin Farmaceutik

Raportit i bashkangjitet :

Kopja e procesverbalit me numër 0110349.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Inspektori: Arif Ahmeti

PROCESVERBALI I INSPEKTIMIT

(Mr. Serbi)

14.06.2025
(Data e fillimit të inspektimit)14.06
(Ora e fillimit të inspektimit)Në subjektin: Barabara D Pharmacy / LS-0074/17/20/2021
(Emri i subjektit të inspektimit)Udhëhequr nga: Hi Ph. Himmora Nubini / RC-0320-03
(Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të subjektit të inspektimit)Në adresën: Fehid Curri, f.n. Akberi - Prishtine
(Adresa e subjektit të inspektimit)Inspektimi është realizuar nga:
Luljeta Mustafa
Altina Rexhe(Emrat dhe mbiemrat e inspektorëve dhe
personave të autorizuar për inspektim)Me numër të dokumentit të identifikimit:
MSH - 0478
MSH - 0939(Numri përkatës i dokumentit të
identifikimit të inspektorit dhe të
personave të autorizuar)Në informatat kontaktuese: Luljeta Mustafa E rks-gov.net
(Adresa elektronike e njërit nga inspektorët dhe numri zyrtar kontaktues)Baza ligjore e inspektimit: Ligji 08/L-057/04/L-05/04/L-190Procesverbali përpilohet për: i paplanifikuar / me ankese
(Lloji i inspektimit)Inspektimi është bërë: me miratim ☒ pa miratim ☐Inspektimi është bërë pa miratim përshkak të: _____
(Arsyeja e inspektimit pa miratim)Pranimi i miratimit të inspektimit është refuzuar nga subjekti i inspektimit: po ☐ jo ☒Ka munguar personi përfaqësues i subjektit të inspektimit: po ☐ jo ☒Miratimi i inspektimit është vendosur fizikisht aty ku është kryer inspektimi: po ☐ jo ☒

Arsyeja për devijimin e inspektimit nga lista e kontrollit të inspektimit është:

Mbrojtja e shëndetit publik
(mbrojtja e interesit publik, shëndetit publik, sigurisë publike dhe/apo e mjedisit, nëse ka ndodhur)

